



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE  
MBËSHTETËSE  
DREJTORIA E MIRËADMINISTRIMIT TË BURIMEVE  
NJERËZORE, ASETIVE DHE SHËRBIMEVE  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3717/prot.

Tiranë, më 07.05.2019

URDHËR

Nr. 287 Datë 07/05/2019

PËR  
NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR MONITORIMIN E SJELLJES SË  
NËPUNËSVE CIVILË GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike",

KONSTATOJ:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr.539, datë 25.04.2019 "Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore", ka orientuar të gjitha institucionet, mbi zbatimin e ligjit për nëpunësit civilë, me qëllim vijueshmërinë normale të punës, të pa ndikuar nga fushata zgjedhore, gjatë veprimtarisë së nëpunësve civilë. Për sa më sipër,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të Punës pranë Ministrisë së Drejtësisë, për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore, me përbërjen si më poshtë vijon:

- Z.Edvin Morava Drejtor i Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Kryetar
- Z.Erjon Ndreca Specialist në Sektorin e Përfaqësimit Gjyqësor, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Anëtar
- ✓ • Z.Helsi Dardeli Specialist në Sektorin e Rregullimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit, Anëtar

- Znj. Matilda Hoxha Specialiste në Sektorin e Rregullimit të Profesioneve të Lira, në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit, Anëtar
- Z. Armand Lamllari Nëpunës Arkivi, në Sektorin e Arkiv Protokollit në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, Anëtar

2. Koordinatori i grupit të monitorimit, do të jetë z. Edvin Morava, Drejtor i Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, i cili do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces, si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

3. Grupi i Punës, deri në datën 10.05.2019, të hartojë Rregulloren e Brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregulla specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqesë për miratim tek Sekretari i Përgjithshëm.

4. Të njihen të gjithë nëpunësit civilë me këtë Urdhër dhe Rregulloren e Brendshme, si dhe të informohet Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës 15.05.2019.

5. Ngarkohet Grupi i Punës, për zbatimin e këtij Urdhri dhe Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e tij.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
Etilda Gjonaj (Saliu)



REPUBLICA E SHqipërisë  
MINISTRIA E DREJTËSISË